

PLANIT OPERACIONAL STOP-INFORMALITETIT



Ministria e Financave, Anila Denaj, zhvilloi mbledhjen e përjavshme të Komitetit ndërinstitucional të Planit Operacional Stop-Infomalitetit, ku bëri një bilanc të rezultateve të tij gjatë muajit Korrik dhe mënyrën sesi ai do të vijojë ai gjatë muajit Gusht. Ministria theksoi se për periudhën në vijim, do të vazhdojë të jetë e shtrirë në të gjithë sektorët e konstatuar me risk: hoteleri-turizëm, hidrokarburet, produktet e akcizës dhe ndërtimit, ku fokus kryesor do të jetë koordinimi më i mirë i strukturave drejt zbulimit të evazionit në shkallë më të gjerë. Gjatë fjalës së saj vuri në dukje se, do të angazhohen në terren 200 studentë të sapo diplomuar të përzgjedhur nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, të cilët do të asistojnë në terren Strukturat e Monitorimit të Administratës Tatimore në kuadër të Planin Operacional kundër Infomalitetit përmes ndërgjegjësimit dhe monitorimit të subjekteve në fushën e Hoteleri-Turizmit.

TASK FORCA NË HIMARË



Ministria Denaj zhvilloi një takim në Himarë, së bashku me Ministrin Çuçi dhe përfaqësues të pushtetit vendor, për Task Forcën e Turizmit. Gjatë fjalës së saj, ministria Denaj, bëri një bilanc të rezultateve të arritura në kuadër të zbatimit të Planit Operacional, në luftë kundër infomalitetit, ku gjatë muajit korrik në të gjithë rajonin Vlorë, Himarë dhe Sarandë, janë realizuar 755 kontrolle nga të cilat, rreth 40% kanë rezultuar me shkelje. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, gjithashtu theksoi se sfida mbetet ende rritja e aftësisë profesionale të burimeve njerëzore. Në këtë aspekt një rol të konsiderueshëm ka pasur edhe zhvillimi i shkollave profesionale, ku në Vlorë janë funksionale tre. Ministria Denaj u bëri thirrje bizneseve që të respektojnë me korrektësi detyrimet ligjore, si dhe të përfitojnë nga lehtësitë fiskale që ka ndërmarrë qeveria shqiptare siç është reduktimi i shkallës së TVSH-së në masën 6%, për të zhvilluar një turizëm të qëndrueshëm.

STOP INFORMALITETIT



Stop infomaliteti, shtrirë në të gjithë bregdetin është ndalur në Himarë, ku ishte e pranishme edhe ministria e Financave dhe Ekonomisë Anila Denaj. Një biznes është gjobitur në Himarë, pasi kishte "shpikur" një faturë tatimore, një formë kjo për t'i shpëtuar deklarimet të fitimeve. Denaj tha se ky biznes lëshonte fatura në gjuhë të huaj dhe është "justifikuar se kjo gjë është për përdorim të brendshëm, por sipas një gjë e tillë është e ndaluar. Ministria Denaj, bashkë me ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Çuçi, në cilësinë e drejtuesve të Task Forcës për turizmin në Himarë e Sarandë, ishin në Gjirin e Gjipesë ku policia liroi një hapësirë plazhi zonë të mbrojtur rreth 3 000 m2. Denaj bëri me dije se, brenda muajit Gusht do të dalim me një paketë më të plotë ligjore për të goditur të gjithë elementët e paligjshmërisë.

PROJEKTI I FISKALIZIMIT



Projektligji "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", prej datës 1 gusht është hedhur për konsultim publik. Ministria e Financës dhe Ekonomisë fton të gjitha grupet e interesit dhe opinionin në tërësi, të japin komentet dhe sugjerimet e tyre, për një proces transparent dhe gjithëpërfshirës. Projektligji, i njohur ndryshe edhe si "Fiskalizimi", për të gjitha palët e interesuara mund ta gjejnë në platformën online: <http://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/195> dhe <https://www.tatime.gov.al/c/424/fiskalizimi>. Faza e konsultimit publik do të zgjasë deri në fund të muajit Gusht 2019, dhe me qëllim garantimin e një komunikimi sa më të plotë janë planifikuar të organizohen tryeza të gjera diskutimi me grupe interesi, si me: kontablistë, specialistë të sektorit të linformacionit dhe Teknologjisë, shoqatat e biznesit, dhomat e tregtisë, Këshillin e Investimeve, Këshillin Konsultativ Tatimor, etj.

RAPORTI MOODY'S DHE S&P



Në raportin e fundit të vlerësimit për financat publike të Shqipërisë nga dy agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit Moody's dhe "Standard and Pools", konfirmuan vlerësimin B+ për borxhin publik të Shqipërisë, me perspektivë të qëndrueshme. Ekspertët e këtyre agjensive, parashikojnë se ekonomia shqiptare do të vazhdojë të zgjerohet. Sipas tyre, për vitin aktual rritja ekonomike pritet të jetë 3.5 për qind, ndërsa për periudhën 2020-2022 ajo parashikohet të shkojë në 3.7 për qind.

EVAZIONI FISKAL-DOGANAT



Ministria e Financave, Anila Denaj, zhvilloi një inspektim në një magazinë doganore në zonën e Porto Romanos, e cila ka rezultuar me mangësi në deklarimin në depozitë. E shoqëruar në këtë inspektim nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Arlind Gjokuta, ministria tha, se muaji Gusht është i fokusuar totalisht tek kontrolli në sektorin e produkteve të akcizës, duke filluar nga karburanti, pijet alkoolike, por edhe më gjerë. Ministria theksoi se kontrollet do të vazhdojnë dhe janë të fokusuar në të gjitha pikat e magazinave doganore në të gjithë vendin. Ministria Denaj i bëri thirrje biznesit të deklarojnë të gjithë mallin e tyre për të patur një proces të pastër të kontrollit. Të zbatojnë ligjin, të respektojnë çdo detyrim për të mos u përballur me gjopa, të cilat nëse janë përsëritëse çojnë deri në mbyllje totale të aktivitetit.

PUNËSIMI PËRMES ZYRAVE TË PUNËS



558 persona janë punësuar përmes zyrave të Punës në gjithë vendin gjatë periudhës 02-08 Gusht 2019. Numrin më të madh të të punësuarve e ka qarku i Tiranës me **133 persona**, ndjekur nga qarku i Vlorës me **123 persona**, qarku i Durrësit me **79 persona**, qarku i Fierit me **56 persona**, qarku i Korçës me **36 persona**, qarku i Lezhës me **35 persona**, qarku i Shkodrës me **33 persona**, etj.